

## SHENIME SHPJEGUESE; Per periudhen 01 Janar deri me 31 Dhjetor 2018

Ne kete aneks paraqiten informacionet shpjeguese ne lidhje me pergatitjen dhe paraqitjen e pasqyrave financiare te njesise ekonomike BIG MARKET sh.p.k.

Njesia ekonomike BIG MARKET sh.p.k e krijuar me date 16.07.2003 ushtron aktivitetin e saj ne fushen Supermarketeve \_ ne qytetin e Tiranes\_, me adrese \_MYSLYM SHYRRI \_.

Per periudhen 01 Janar 2018 deri me 31 Dhjetor 2018 jane pergatitur dhe paraqitur paketa e plote e pasqyrave financiare, te cilat japin pamjen te vertete dhe te drejte te pozicionit financiar, performances financiare dhe fluksit te parase gjate kesaj periudhe.

Pergatitja dhe paraqitja e tyre, e cila eshte pergjegjesi e Drejtimit te subjektit, eshte realizuar mbeshtetur ne Ligjin nr 9228 date 29.04.2004 "Per Kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare", ne Standardet Kombetare te Kontabilitetit (SKK) te permiresuara te miratuara nga Keshilli Kombetar i Kontabilitetit(KKK). Gjuha e perdorur eshte gjuha shqipe. Monedha e perdorur eshte monedha Leke. Rrumbullakime te vlerave nuk ka. Ngjarjet dhe trasaksionet jane evidentuar gjate gjithe periudhes ushtrimore ne perputhje me SKK nr 1 Kuadri i pergjithshem per pergatitjen e pasqyrave financiare dhe SKK nr 2 Paraqitja e pasqyrave financiare si dhe cdo standard tjetër kombetar ne perputhje me natyren e ngjarjeve apo trasaksioneve te cilat ne menyre te hollesishme do te jepjen ne vijim te informacioneve shpjeguese.

### ❖ Shenime shpjeguese ne lidhje me zerat e paraqitur ne pasqyren BILANC.

Paraqitja e kesaj pasqyre eshte mbeshtur ne paketen e plote te standardeve te permiresuara te miratuara nga Keshilli Kombetar i Kontabilitetit. Ne vijim do te jepjen informacionet shpjeguese per zerat perberes te saj.

#### I. Informacione Shpjeguese per AKTIVET.

Totali i aktiveve te paraqitura ne pasqyren e Bilancit jane ne vleren **34056486 leke** detajimi nepermjet informacioneve shpjeguese i te ciles paraqitet si vijon;

#### ↓ Informacione shpjeguese te AKTIVE AFATSHKURTRA

Aktiveve afatshkurtra jane paraqitur ne vleren **30914246 leke** te cilat jane te perbera nga;

**1.Aktive monetare 3814827** . Ky ze eshte paraqitur ne pasqyre duke u mbeshtetur edhe ne SKK nr 12 *Efektet e ndryshimeve te kurseve te kembimit* dhe paraqet tepricen e llogarise Arka dhe tepricen e llogarise banke, ne monedhen lek dhe euro ne date 31.12.2018. Kursi i kembimit eshte perdorur ne menyre sistematike gjate gjithe ushtrimit te aktivitetit te subjektit per ngjarjet e trasaksionet te cilat jane kryer ne monedha te huaja.

**2.Te drejta te arketueshme** te cilat jane paraqitur ne vleren **7333560leke** dhe eshte e perbere nga;

**Zeri, Nga aktiviteti i shfrytëzimit** ne vleren **6295827leke**, i cili eshte evidentuar edhe ne perputhje me SKK nr 3 ne te cilen përfshihen të gjitha të drejtat e krijuara gjate periudhes ushtrimore ndaj klientave për shitjen e mallrave, produkteve dhe shërbimeve me arkëtim të mëvonshëm, te paraqitura me vleren neto te realizueshme.


**Zeri, Kerkesa ndaj tatim taksave dhe te treteve** ne vleren **1037733leke**, pëfshihen të gjitha të drejtat e njësishë ndaj të tretëve, te krijuar gjate periudhes ushtrimore i cili eshte i berbera prej;

Parapagim qeraje	438	960000
tatim fitim	444	77733

**3.Inventari** i paraqitur ne vleren**19765859leke**, i cili eshte i perbere prej;

**Zeri Lëndë e parë dhe materiale të konsumueshme** ne vleren **112770719 leke** jane njohur dhe vleresuar ne perputhje me SKK nr 4 *Inventaret*. Kostoja e inventarit eshte vleresuar me metoden e kosos mesatare te ponderuar.

Mallrat e blera gjate periudhes ushtrimore jane **115405754leke** dhe kosto e mallrave te shitur e cila eshte pasqyruar ne pasqyren e te ardhurave dhe shpenzimeve eshte 2635035 leke.





↓ **Informacione shpjeguese te AKTIVET AFATGJATA**

Aktivët afatgjata janë paraqitur në Vlerën Kontabel Neto **3142240**leke. Ato janë evidentuar edhe në përputhje me SKK nr 5 Aktivët afatgjata materiale dhe aktivët afatgjata jomateriale. Paraqitja e tyre është bërë nëpërmjet politikës kontabel Metoda e Kostos. Përberja e këtij zeri paraqitet si vijon;

**1. Aktive afatgjata materiale** janë në vlerën **3142240**leke dhe është i përbërë nga zeri *Të tjera Instalime dhe pajisje* në vlerën **3142240** leke. Metoda e përzgjedhur për amortizimin është metoda mbi vlerën e mbetur, dhe është njohur në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve për periudhën ushtrimore në vlerën **803979** leke.

Në të janë të përfshirë elementet e mëposhtem;

Nr. Llogarie	Emertimi i Llogarise	Monedha	Debi	Kredi
2182	Pajisje informative	LEK	2154758	
2188	Të tjera	LEK	6429472	
281801	Per Pajisje Informative	LEK		-2102557
281803	Per te tjera	LEK		-3539433

**Totali: 3142240**

**Diferenca:**

**II. Informacione Shpjeguese per DETYRIMET.**

Detyrimet e paraqitura në pasqyrën e Bilancit janë në vlerën **34056486**leke dhe përbehet vetëm nga detyrime të periudhave afatshkurtra. Detajimi jepet nëpërmjet informacioneve shpjeguese si vijon;

↓ **Informacione shpjeguese te DETYRIMEVE AFATSHKURTRA**

Detyrimet afatshkurtra janë paraqitur në total në vlerën **25728958** leke, dhe janë të përbera nga detyrimet ndaj furnitoreve, punonjësve, detyrime ndaj shtetit për tatime dhe taksa.

- Titujt e huamarrjes në vlerën **0** leke përbejnë huamarrjet afatshkurtra të njesise ekonomike të cilat do të shlyen në periudhën e ardhshme ushtrimore.

- Të pagueshme për aktivitetin e shfrytëzimit në vlerën **24244243**leke paraqesin detyrimin e papaguar për blerjen e mallrave nga furnitorë të ndryshëm të njesise ekonomike në fund të vitit 2018.

- Të pagueshme ndaj punonjësve dhe sigurimeve shoqërore/shëndetsore në vlerën **207642**leke përbejnë vetëm detyrimin për pagat e personelit të papaguara deri në fund të vitit 2018 si dhe detyrimin për sigurimet shoqërore dhe shëndetsore për muajin Dhjetor 2018 dhe detajohet si vijon;

Elementi	Ref	Vlera
Pagat e personelit	421	54121
Sigurime shoqërore shëndetsore & tap	431+442	153521

- Të pagueshme për detyrimet tatimore në vlerën **1277073**

leke përbejnë detyrimin për muajin Dhjetor 2018 dhe detajohet si vijon;

Elementi	Ref	Vlera
Shteti- TVSh për tu paguar	4453	1187073
Tatim në burrim	4471	90000





#### ↓ Informacione shpjeguese te DETYRIMEVE AFATGJATA

Detyrimet afatgjata jane paraqitur ne total ne vleren 0 leke.

#### III. Informacione Shpjeguese per KAPITALIN

Kapitali i paraqitur ne vleren 3100000 leke dhe eshte i perbere nga zerat Kapital i nenshkruar, Fitime te Pashperndara dhe Fitim / Humbje e vitit, detajimi i te cilave do te jepet ne informacionet shpjeguese.

##### 1. Informacione shpjeguese te zerit KAPITAL

Ne kete ze jane paraqitur kapitali i kontribuar nga aksionerët ose nga ortakët dhe jane përmbledhur tepricat kreditore të llogarive vijuese:

Emertimi	Ref	Vlera
Kapitali i paguar,	101	3100000
Totali		3100000 leke

Ne perputhje me aktin e themelimit date 09.07.2003 kapitali i kontribuar eshte i perbere nga Kuota ose aksione, gjithsej:

- 1-Z VULLNET SINAJ 60 aksione \*1000 qe perben 60 % te kapitalit themeltar ,vlera ne para eshte 60000 leke .
- 2- Z.ILIR SALIAJ 40 aksione \*1000 perben 40 % te kapitalit themeltar . vlera ne para eshte 40000 leke .

Ne baze te vendimit 15.12.2008 jane rritur aksionen perkatesisht :

- 1-Z VULLNET SINAJ 1860 aksione \*1000 qe perben 60 % te kapitalit themeltar ,vlera ne para eshte 1860000 leke .
- 2- Z.ILIR SALIAJ 1240 aksione \*1000 perben 40 % te kapitalit themeltar . vlera ne para eshte 1240000 leke .

##### 2. Informacione shpjeguese te zerit FITIME TE PASHPERNDARA

Zeri *Fitime te pashperndara* paraqitet ne vleren 0 leke dhe perfshin fitimet që njësia ekonomike ka akumuluar nga periudhat paraardhëse.


##### 3. Informacione shpjeguese te zerit FITIM / HUMBJE E VITIT

Zeri *Fitim / Humbje e vitit* paraqitet ne vleren **5120964 leke** dhe paraqitet rezultati i periudhës rrjedhese ushtrimore të njësisë raportuese ashtu si rezulton nga pasqyra e të ardhurave dhe shpenzimeve pasi eshte zbritur tatimi mbi fitimin.

#### ❖ Shenime shpjeguese ne lidhje me zerat e paraqitur ne pasqyren TE ARDHURAVE DHE SHPENZIMEVE.

Pasqyra e te Ardhurave dhe Shpenzimeve eshte paraqitur bazuar ne klasifikimin e shpenzimeve sipas natyres. Ne kete periudhe ushtrimore ka rezultuar nje fitim ne vleren **5120964 leke**.

Zeri *Të ardhura nga aktiviteti i shfrytëzimit* te paraqitura ne pasqyre evidenton te gjitha shitjet e realizuara me vleren e tyre neto **134386979 leke**.



**Zeri Lënda e parë dhe materiale të konsumueshme** te paraqitura ne vleren **112770719 leke** perfaqesojne koston e mallrave te blera per qellime rishitje. Politika kontabel eshte paraqitur me larte ne zerin *Mallra per shitje* (Inventar).

**Zeri Shpenzime të personelit** i cili eshte i paraqitur ne vleren **10165491leke** perfaqeson:

Shuma *Paga dhe shpërblime* gjate periudhes ushtrimore 01.01.2018-31.12.2018 ne vleren**8737043leke**.

Shuma *Shpenzime të sigurimeve shoqërore/shëndetsore (paraqitur veçmas nga shpenzimet për pensionet)* gjate periudhes ushtrimore 01.01.2018-31.12.2018 ne vleren**1428448leke**.

Nga keto vlera vetem shuma 153521 **leke** eshte ende e papaguar e cila eshte pasqyruar ne bilanc, dhe per te cilen jane dhene informacione shpjeguese me larte.

**Zeri Shpenzime të tjera shfrytëzimi** te cilat jane te paraqitura ne vleren **11537281leke** perfaqesojne shpenzimet te cilat jane kryer per zhvillimin e aktivitetit te njesise ekonomike, dhe perfaqeson zera te shpenzimeve si furnitura, taksa te ndryshme dhe te tjera.

**Zeri te ardhura te tjera** te cilat jane te paraqitura ne vleren **17159leke**, perfaqesojne te ardhurat dhe shpenzimet qe vijne nga interesa bankare,interesa kredie, overdrafti si dhe diferenca negative dhe pozitive nga kurset e kembimit.

❖ **Shenime shpjeguese ne lidhje me zerat e paraqitur ne pasqyren CASH FLOW.**

Ne pasqyren e flukseve monetare jane paraqitur flukset hyrese dhe dalese te mjeteve monetare në njësinë ekonomike gjatë periudhës korrente kontabël. Paraqitja eshte bere sipas metodes indirekte.

Gjate periudhes kontabel ka rezultuar;

Mjete monetare neto nga/(përdorur në) aktivitetin e shfrytëzimit ne vleren **6453210 leke**. Fluksi pozitiv ka ardhur pasi flukset dalese te mjeteve monetare per kryerjen e shpenzimeve si psh, paga, detyrime per kontribute te sigurimeve dhe te tatim-taksave jane me te ulta se flukset hyrese te mjeteve monetare gjate ushtrimit normal te aktivitetit nga njesia ekonomike.

Mjete monetare neto nga/(përdorur në) aktivitetin e investimit ne vleren**-271843 leke** i cili ka ardhur si rezultat i blerjes se aktiveve afatgjate materiale.

Mjete monetare neto nga/(përdorur në) aktivitetin e financimit ne vleren **-5049526**

❖ **Shenime shpjeguese ne lidhje me zerat e paraqitur ne pasqyren NDRYSHIMEVE TE KAPITALIT .**

Ndryshimet ne zerin Kapital kane ardhur si rezultat;

Fitim / Humbje e vitit ne vleren **5120964leke**.

Informacionet shpjeguese per zerat e mesiperm jane dhene ne pasqyren e Bilancit.



Drejtori  
*[Signature]*

Hartuesi  
*[Signature]*